
AKT THEMELIMI

"S Construction and Development" SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë **"S Construction and Development" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortakë të shoqërisë janë:

- **"KASTRATI" SHPK** me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë;

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Kryerja e aktiviteteve, për të eilat nevojiten leje, licenca dhe/ose autorizime perkatese, do të bëhet pas marrjes së ketyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve. Ndërtim, Projektim, konsulencë, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit. Import-eksport i të gjithë llojeve të materialeve dhe makinerive të ndërtimit. Ndërtim Pallatesh dhe kompleksesh të ndryshme banimi, konstruksione të të gjitha llojeve dhe punime restaurimi të objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shëndetësore, kulturore, sportive. Ndërtim e riparim rrugësh, punime e mirëmbajtje të traseve hekurudhore. Prodhim inertesh të të gjitha llojeve. Veprimtari minerare, zbulim, zhvillim, shfrytëzim. Import -eksport të mjeteve të mekanizuara, makineri e transport, automjeteve të ndryshme, materialeve të ndërtimit. Ndërtim, permiresim, mirembajtje të rrugeve, autostradave, mbikalimeve dhe nenkalimeve, urave, tuneleve, porteve, aeroporteve, digave, hidrocentraleve dhe veprave të tjera të infrastruktures, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm, ndihmes apo plotësues në funksion të objektit kryesor të shoqërisë. Formimin profesional për sigurinë dhe shëndetin në punë.**

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 1 000 000 (nje milion leke).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 1 000 000 (nje milion leke) dhe zotërohet nga Ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjeve në kapitalin e shoqërisë sa më sipër.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Enea Alinj, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 14.11.1995, banues në Tiranë, e identifikuar nga pasaporta me nr. BA3076667 dhe nr. personal J51114028G.**

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKËT E

SHOQËRIË "S Construction and Development" SHPK

"KASTRATI" SHPK

Përfaqësuar nga Z/Zj.

Eda Spahiu

Eda Spahiu 



Tiranë më **07.01.2025**